



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

Tiranë, 29.06.2016

Lënda: Paraqitja e projektligjit “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe procesi për shqyrtimin e tij nga Kuvendi

Drejtuar :

z.Illir META
Kryetar i Kuvendit

Në vëmendje :

Konferencës së Kryetarëve të Kuvendit

I nderuar z. Kryetar,

Kuvendi, në zbatim të nenit 77 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 24 të Rregullores së tij, me vendimin nr.96/2014 ka vendosur ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë.

Komisioni i Posaçëm, ndër të tjera, ka për objekt të veprimtarisë së tij edhe: (iii) Propozimin për miratim të një pakete të plotë projektligjesh të nevojshme për reformimin e legjislacionit, që rregullon organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të drejtësisë, përfshirë ato kushtetuese, e hartuar me kontributin dhe mbështetjen e institucioneve të sistemit të drejtësisë, ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, subjekteve të tjera të interesuara dhe opinionit publik (pika 2 e vendimit).

Për realizimin e detyrave të përcaktuara, pranë komisionit të posaçëm parlamentar, është ngritur dhe ka funksionuar Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), i cili asistohet nga sekretariati teknik, detyra e të cilëve ndër të tjera ka qenë ajo për hartimin e projektligjeve të reformës në drejtësi (pikat 7 e 8 të vendimit).

KUVENDI		
Shenimi i Kryetarit		dt. _____
Futja ne program		dt. _____
Shqyrtimi ne seance		dt. _____

Në përputhje me vendimin nr.96/2014 dhe vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, Grupi i ekspertëve të Nivelit të Lartë, vendas e ndërkombëtarë, ka hartuar projektligjin “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji, siç edhe është bërë e njohur publikisht përmes medias, i është nënshtruar një procesi të gjerë konsultimesh me ekspertë të fushës, me institucionet përkatëse të sistemit të drejtësisë, me grupet e interesit dhe përfaqësues të shoqërisë civile si dhe është bërë publik përmes faqes së internetit të reformës në drejtësi.

Në përfundim të të gjithë këtij procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, projektligji është dorëzuar/depozituar në fillim të muajit qershor në Komisionin e posaçëm parlamentar i cili e ka përfshirë në kalendarin e punës së tij për shqyrtim në parim, nen për nen dhe në tërësi (vendimi nr.20, datë 14.06.2016).

Ky komision në mbledhjet e tij të datave 20 dhe 29 qershor është njohur me përmbajtjen e projektligjit.

Komisioni ka caktuar relatorin për projektligjin dhe është duke vazhduar punën për shqyrtimin e mëtejshëm të tij, sipas kalendarit të punimeve të komisionit.

Në përfundim të këtij procesi, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë (nenet 24, 29, 38, 39, 41, 68, 69 dhe 70) dhe në zbatim të detyrës së ngarkuar nga Vendimi nr.96/2014 të Kuvendit të Shqipërisë, do ta paraqesë projektligjin për shqyrtim e miratim në seancën plenare të përcaktuar në kalendarin e punës së Kuvendit.

Bashkëngjitur do të gjeni një kopje të këtij projektligji së bashku me relacionin përkatës.

Me respekt

Fatmir XHAFAJ

Deputet



Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë

PROJEKTLIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROKURORISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është:

- a) përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë;
- b) përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedura për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm;
- c) rregullimi i marrëdhënieve të Prokurorisë me institucionet e tjera shtetërore, me subjekte të tjera publike ose private dhe me publikun.

Neni 2 Përkufizime

1. Për qëllime të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Prokuroria e Posaçme” është autoriteti përgjegjës për ndjekjen penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë;
- b) “Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar” përdoret për t’iu referuar Prokurorisë së Posaçme dhe njësisë së pavarur hetimore, e cila do të quhet “Byroja Kombëtare e Hetimit”;

- c) “Prokuror më i lartë” është:
- i) Prokurori i Përgjithshëm për Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme dhe për drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe shkallës së parë;
 - ii) Drejtuesi i prokurorisë së apelit për prokurorët e apelit në strukturën përkatëse, ku ushtrojnë funksionet;
 - iii) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë për prokurorët e strukturës përkatëse.
- ç) “Drejtues” është titullari / drejtuesi i çdo prokurorie, përfshirë Prokurorinë e Posacme.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së Prokurorisë

1. Prokuroria ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit në gjyq, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, drejton dhe kontrollon veprimtarinë e policisë gjyqësore si dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.
2. Prokuroria i ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur nëpërmjet prokurorëve.

KREU II

PARIMET THEMELORE TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË PROKURORISË

Neni 4

Ligjshmëria e veprimtarisë

1. Prokurorët në ushtrimin e detyrës u nënshtrohen Kushtetutës, marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe ligjeve të tjera në fuqi.
2. Prokurorët i ushtrojnë kompetencat e tyre duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe interesit publik.

Neni 5

Detyrueshmëria e ndjekjes penale

Ushtrimi i ndjekjes penale është i detyrueshëm, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe.

Neni 6

Pavarësia e prokurorëve

1. Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët veprojnë dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe paanshmërisë.
2. Prokurorët i nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji.
3. Çdo lloj ndikimi i papërshtatshëm mbi punën e prokurorëve dhe veprimtarinë e tyre në çështje konkrete, i ushtruar përmes autoritetit publik, mjeteve të informacionit apo me çdo lloj mjeti tjetër apo personave të tjerë, që cënon pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e detyrës së tyre, është i ndaluar dhe dënohet sipas ligjit.

Neni 7

Mbrojtja dhe statusi i prokurorit

1. Prokurorëve dhe familjarëve të tyre u garantohet mbrojtje e vecantë nga Shtetit në rast se, për shkak të ushtrimit të detyrës, i kërcënohen jeta, shëndeti, familja apo prona.
2. Statusi i prokurorëve përcaktohet nga ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8

Objektiviteti dhe barazia

Prokurorët sigurojnë trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykim për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, fesë, etnisë, gjuhës, bindjeve politike, fetare a filozofike, orientimit seksual, gjendjes ekonomike, pronës, arsimimit, lindjes, aftësisë së kufizuar, prejardhjes shoqërore, përkatësisë prindërore ose për arsye të tjera.

{ XE "KREU I" }

Neni 9

Konfidencialiteti i të dhënave

1. Prokurorët dhe gjithë personeli i prokurorisë janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin shtetëror për fakte për të cilat vijnë në dijeni gjatë ushtrimit të detyrës së tyre, si edhe pas përfundimit të saj, me përjashtim të rasteve kur ligji përcakton ndryshe.
2. Prokurorisë nuk i lejohe të bëjë publike ose t'u japë personave të tretë të dhëna që mund të dëmtojnë çështjen në proces hetimi apo gjykimi, ato që çënojnë dinjitetin dhe jetën private të personave, të drejtat e të miturve si dhe të dhëna me karakter konfidencial ose të rezervuar.
3. Prokurorëve u ndalohet të bëjnë deklarata ose të japin mendime për veprimtarinë e organeve të tjera.

Neni 10

Respektimi i rregullave të etikës dhe sjelljes profesionale

Prokurorët duhet të ruajnë në çdo kohë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre dhe të sillen në mënyrë profesionale, në përputhje me ligjin dhe rregullat e etikës.

Neni 11

Ushtrimi i funksioneve të prokurorisë vetëm nga prokurorët

1. Funksionet e prokurorisë ushtrohen vetëm nga prokurorët e Republikës së Shqipërisë, të emëruar sipas ligjit.
2. Delegimi i funksioneve të prokurorisë apo marrja përsipër e këtyre funksioneve nga autoritete të tjera është e ndaluar, *me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe*¹.

KREU III

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PROKURORISË

Neni 12

Struktura e prokurorisë

Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor, me përjashtim të Prokurorisë së Posaçme, që rregullohet me ligj të posacëm.

Neni 13

Degët e Prokurorive²

1. Në rastin kur janë ngritur degë të gjykatave, mbledhja e përgjithshme e prokurorisë përkatëse, bazuar në objektivat e parashikuara në nenin 20 të këtij Ligji, përcakton nëse pranë tyre duhet të ngrihet një degë e përhershme ose e përkohshme e prokurorisë.
2. Prokurorët caktohen në degët e prokurorisë me pëlqimin e tyre. Nëse asnjë prokuror nuk jep pëlqimin për caktimin në një një degë të gjykatës, Këshilli i Lartë Prokurorisë i cakton ata me short çdo dy vjet në degë të gjykatës, duke u bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë.
3. Shpenzimet që lidhen me ushtrimin e detyrave pranë degëve të gjykatave do të mbulohen nga buxheti i prokurorisë përkatëse.

Neni 14

Organizimi i prokurorisë dhe përfaqësimi i saj

¹ Këtu merret në konsideratë diskutimi nëse do të vazhdojë të lejohet delegimi nga prokurori i funksioneve e ushtrimit të ndjekjes penale oficerit të policisë gjyqësore, sipas rregullimit të Kodit të Procedurës Penale.

² Ky rregullim i referohet projektligjit për organizimin gjyqësor. Mendimi i ekspertëve është që, së paku, krijimi i degëve në fushën penale nuk është i nevojshëm.

1. Prokuroria përbëhet nga:
 - a) Prokuroria e Përgjithshme e Republikës;
 - b) Prokuroria e Posaçme, sipas ligjit të veçantë;
 - c) Prokuroritë pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
 - ç) Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.
2. Drejtimi dhe përfaqësimi i prokurorisë, sipas këtij organizimi, bëhet, respektivisht, nga:
 - a) Prokurori i Përgjithshëm;
 - b) Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme;
 - c) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm;
 - ç) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.

Neni 15 **Prokuroria e Përgjithshme**

1. Prokuroria e Përgjithshme, me qendër në Tiranë, ka juridiksion mbi të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Prokuroria e Përgjithshme përfaqëson çështjet përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, me përjashtim të çështjeve të juridiksionit të Prokurorisë së Posaçme, dhe kryen detyra të tjera të parashikuara me ligj.
3. Funkcionet e Prokurorisë së Përgjithshme ushtrohen nga prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 16 **Prokuroria e posaçme**

1. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar si dhe veprat penale të kryera nga funksionarë të lartë, sipas përcaktimeve të bëra me ligj.
2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë së Posaçme si dhe marrëdhëniet e saj me institucionet e tjera shtetërore, dhe me subjekte të tjera publike ose private, rregullohen sipas ligjit të veçantë.

Neni 17 **Prokurorët pranë gjykatave të apelit**

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate apeli të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokurorët e apelit. Juridiksioni i tyre shtrihet në territorin e juridiksionit të gjykatës përkatëse.

Neni 18
Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë

Funksionet e Prokurorisë pranë çdo gjykate të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm ushtrohen nga prokurorët e shkallës së parë. Juridiksioni i tyre shtrihet në territorin e juridiksionit të gjykatës përkatëse.

Neni 19
Numri i përgjithshëm i prokurorëve

1. Prokurori i Përgjithshëm propozon numrin e përgjithshëm të prokurorëve dhe buxhetin për të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, bazuar në kërkesat e tyre.
2. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme propozon numrin e përgjithshëm të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe buxhetin e kësaj prokurorie.
3. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, në ushtrimin e funksioneve si më sipër, krahas garantimit të veprimtarisë të prokurorisë, mbajnë në konsideratë edhe nevojën e sigurimit të aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë, uljen e shpenzimeve, përdorimin e të ardhurave publike në mënyrë eficiente, dhe rritjen e cilësisë e shërbimeve të prokurorisë.
4. Numri i përgjithshëm i prokurorëve propozohet bazuar në raportin mbi ngarkesën e punës së prokurorive, duke marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Këshillit i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit gjatë, të paktën, tre viteve të fundit.

Neni 20
Numri i prokurorëve për çdo prokurori

1. Prokurori i Përgjithshëm publikon, brenda muajit qershor të çdo viti, raportin vjetor mbi ngarkesën e punës së prokurorive për vitin kalendarik paraardhës, si dhe rekomandimet për përmirësimin dhe rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së tyre.
2. Së paku çdo pesë vjet, Prokurori i Përgjithshëm vlerëson numrin e prokurorëve për çdo prokurori dhe, nëse është e përshtatshme, ripërcakton numrin e tyre, pasi ka marrë mendimin e drejtuesëve të prokurorive përkatëse.
3. Vendimi për përcaktimin e numrit të prokurorëve për çdo prokurori pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe Prokurorisë së Posaçme duhet të marrë në konsideratë objektivat e përcaktuara në nenin 19 të këtij ligji, dhe të synojë garantimin e një ngarkese të balancuar pune për të gjithë prokurorët dhe prokuroritë e vendit. .

Neni 21
Struktura e prokurorive

Struktura e prokurorive përcaktohet në rregulloren e organizimit të brendshëm të secilës prokurori, sipas strukturës së përgjithshme / standarde të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

Neni 22

Seksionet e prokurorive

1. Në çdo prokurori për kategori të caktuara veprash penale, kur është e mundur dhe e nevojshme, me vendim të mbledhjes së përgjithshme të prokurorëve, ngrihen seksione të përbëra nga të paktën tre prokurorë. Ngritja e tyre bazohet, ndër të tjera, në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin dhe intensitetin e veprave penale si dhe në rekomandimet e Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.
2. Drejtuesit e seksioneve emërohen nga drejtuesi i prokurorisë nga radhët e prokurorëve të seksionit, të cilët kanë të paktën 5 vjet përvojë si prokurorë, rezultate të mira në punë dhe aftësi organizative.

KREU IV

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

SEKSIONI I

KUSHTET DHE KRITERET PËR ZGJEDHJEN E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

Neni 23

Kushtet ligjore për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm

1. Kandidati për Prokuror të Përgjithshëm duhet të përmbushë kushtet e parashikuara nga neni 148/a i Kushtetutës. Për efekt të integritetit moral dhe profesional, sipas nenit 148/a të Kushtetutës, kandidati për Prokuror të Përgjithshëm duhet të plotësojë kushtet si vijon:
 - a) të kalojë verifikimin e pasurisë dhe lidhjeve të tjera, sipas legjislacionit në fuqi;
 - b) të mos jetë subjekt i ligjit për bashkëpunëtorët me Sigurimin e Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe funksionarët e tjera të parashikuara prej tij;
 - c) të plotësojë kërkesat e ligjit për dekriminalizimin;
 - ç) në periudhën 29.11.1944 – 02.07.1991, të mos ketë qenë anëtar ose kandidat i Byrosë Politike, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, anëtar i Presidiumit të Kuvendit Popullor, kryetar i Gjykatës së Lartë, Prokuror i Përgjithshëm, Kryetar i Hetuesisë së Përgjithshme, anëtar i Këshillit të Ministrave, kryetar i degëve të punëve të brendshme, punonjës i organeve të ish-Sigurimit të Shtetit, bashkëpunëtor i ish-Sigurimit të Shtetit apo i favorizuar, anëtar i Komisionit Qendror të Dëbim-Internimeve, hetues, prokuror, gjyqtar në procese politike, denoncues apo dëshmitar i akuzës në proceset politike të posaçme;
 - d) të mos jetë bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve sekrete të huaja.

dh) të mos jetë në kushtet që parashikohen në nenin 148/d të Kushtetutës.

Neni 24

Kriteret për vlerësimin e kandidatëve

1. Kandidatët që përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, vlerësohen dhe renditen nga Këshilli i Lartë Prokurorisë bazuar në këto kritere:
 - a) rezultatet e vlerësimit profesional të kandidatit në fushën e drejtësisë penale;
 - b) integritetit moral dhe profesional i kandidatit;
 - c) aftësitë organizative, drejtuese dhe menaxheriale;
 - ç) vlerësimin të kriterëve shtesë, sipas nenit 28 të këtij ligji.
2. Në rastet kur kandidatët kanë të njëjtën meritë, vlerësohet vjetërsia në ushtrimin e profesionit dhe eksperiencat profesionale.
3. Këshilli në zbatim të dispozitave të këtij kreu përcakton me akt normativ:
 - a) mënyrën e organizimit të procesit të vlerësimit të kandidatëve, sipas kriterëve të parashikuara në këtë ligj;
 - b) kriteret për matjen e rezultateve të vlerësimit në profesion dhe kriteret e tjera të përcaktuara në këtë ligj;
 - c) procedurën që ndiqet në rastin e kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta.

Neni 25

Kriteret e vlerësimit profesional

1. Vlerësimi profesional i kandidatëve bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale dhe njohurive/ kualifikimeve ligjore të tyre, si më poshtë:
 - a) për kandidatët prokurorë: rezultatet e dy vlerësimeve të fundit të eksperiencës në punë;
 - b) për kandidatët e tjerë juristë: vlerësimi do të kryhet sipas përvojave konkrete të tyre, që lidhen me ushtrimin e funksioneve në fushën e drejtësisë penale;
 - c) rezultatet e arritura gjatë studimeve të larta në drejtësi, formimit fillestar dhe atij të vazhdueshëm në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit;
 - ç) përfundimi i studimeve pasuniversitare në fushën e së drejtës penale dhe rezultati i arritur në përfundim të tyre;
 - d) vlerësimi i publikimeve dhe pjesëmarrja në aktivitete shkencore të kandidatit përgjatë pesë viteve të fundit.

Neni 26

Kriteret e vlerësimit të integritetit moral dhe profesional

1. Integriteti moral dhe profesional i kandidatit përcaktohet nga reputacioni që ai gëzon në shoqëri si rezultat i mënyrës së të sjellurit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe më gjerë.

2. Vlerësimi i integritetit të tij bazohet edhe në cilësitë morale që një prokuror duhet të zotërojë si dhe në sjelljen e tij, në mënyrë koherente në shoqëri..
3. Vlerësimi i kandidatëve bazohet në zotërimin e cilësive morale të tilla si, ndershmëria, përpikmëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në vendimmarrje, përgjegjëria besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe marrjes përsipër të përgjegjësive.
4. Përveç sa parashikohet në nenin 23 të këtij ligji, rregullime të mëtejshme për zbatimin e këtyre kritereve përcaktohen në rregulloren e miratuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas nenit 24 të këtij ligji.

Neni 27

Kriteret e vlerësimit të aftësive organizative, drejtuese dhe manaxheriale

1. Aftësitë organizative, drejtuese dhe manaxheriale të kandidatit vlerësohen sipas kritereve të mëposhtme:
 - a) platformës dhe vizionit të drejtimit dhe garantimit të suksesit të veprimtarisë së Prokurorisë;
 - b) aftësive për të marrë përgjegjësi dhe vendime, bazuar edhe në përvojat e mëparshme në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë;
 - c) aftësive të komunikimit;
 - ç) aftësive të të punuarit në grup;
 - ç) aftësive të përfaqësimit të institucionit dhe prezantimit të veprimtarisë së tij.

Neni 28

Kritere të tjera vlerësimi

- Krahas kritereve të parashikuara në nenet 25, 26 dhe 27 të këtij ligji, në vlerësimin e kandidatëve do të merren në konsideratë edhe:
- a) zotërimi i gradave shkencorë, për kandidatët që kanë përfunduar Shkollën e Magjistraturës;
 - b) zotërimi i titujve shkencorë;
 - c) studime dhe trajnime afatgjata jashtë vendit;
 - ç) njohja e gjuhëve të huaja.

SEKSIONI II

PROCEDURA E PËRZGJEDHJES DHE EMËRIMIT

Neni 29

Organi përgjegjës për përzgjedhjen

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë përzgjedh kandidaturat për Prokuror të Përgjithshëm, ndër ata që përmbushin kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë ligj.

2. Këshilli, në përzgjedhjen e kandidaturave zbaton rregullat e këtij seksioni. Rregulla më të detajuara për procedurën e përzgjedhjes miratohen me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Neni 30

Thirrja për aplikime

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të paktën 3 muaj përpara mbarimit të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm, shpall thirrjen për aplikim për pozicionin e Prokurorit të Përgjithshëm.
2. Njoftimi i thirrjes bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe përmes shpalljes në një gazetë me shpërndarje kombëtare dhe tirazh të mjaftueshëm ose në Radio Televizionin Publik.
3. Njoftimi përmban informacion lidhur me:
 - i) afatin e paraqitjes së kërkesave për kandidim;
 - ii) dokumentacionin që duhet t'i bashkëlidhet kërkesës për kandidim;
 - iii) kriteret, procedurën dhe metodologjinë e vlerësimit të kandidaturave;
 - iv) mënyrën dhe vendin e dorëzimit të kërkesave për kandidim.

Neni 31

Paraqitja e kërkesave për kandidim

1. Kërkesat për kandidim paraqiten pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, brenda 15 ditëve nga njoftimi publik, të shoqëruara nga dokumentacioni që vërteton përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të parashikuara me ligj. Depozitimi i kërkesës prej kandidatëve, në cdo rast publikohet menjëherë në faqen zyrtare të Këshillit.
2. Kërkesës i bashkëlidhen gjithashtu edhe dokumentet e mëposhtme:
 - a) jetëshkrimi i kandidatit;
 - b) deklaratë personale motivimi, për arsyen e kandidimit dhe objektivat që synon të përmbushë nëse emërohet në detyrë;
 - c) deklaratë përkundrejt përgjegjësisë ligjore, që nuk ka pengesë për emërim, sipas nenit 23, paragrafi 1, shkronjat ç) dhe d) të këtij ligji;
3. Këshilli, kur e vlerëson të nevojshme, mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nga kandidati dhe nga organet publike ose punëdhënësi i kandidatit.

Neni 32

Verifikimi paraprak i kushteve ligjore

1. Brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të dorëzimit të kërkesave për kandidim, komisioni përgjegjës për emërimet/karrierën në Këshillin e Lartë të Prokurorisë kryen vlerësimin paraprak nëse kandidatët përmbushin kushtet ligjore të parashikuara në nenin 23 të këtij ligji, bazuar në parimin e barazisë para ligjit, ndalimit të diskriminimit dhe ndershmërisë në vlerësim.

2. Komisioni shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati dhe kërkon informacion për verifikimin e të dhënave për gjendjen gjyqësore si dhe të çdo shkakut tjetër skualifikues nga gjykata, prokuroria, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimeve, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ tjetër me të cilin aplikanti ka pasur marrëdhënie pune.

3. Në përfundim të vlerësimit paraprak, komisioni harton listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet ligjore dhe të kandidatëve të skualifikuar dhe ia paraqet atë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, bashkë me raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga çdo kandidat dhe atë të grumbulluar, sipas pikës 2 të këtij neni. Ky dokumentacion i vihet në dispozicion çdo kandidati, me kërkesën e tij. Lista publikohet edhe në faqen zyrtare të Këshillit.

4. Aplikuesit që nuk janë përfshirë në listën sipas paragrafit 3 të këtij neni, njoftohen me shkrim nga Komisioni për faktin dhe arsyet e mospërfshirjes. Ata kanë të drejtë të paraqesin ankim pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.

5. Këshilli merr vendim të arsyetuar për pranimin ose refuzimin e ankesave dhe miraton listën brenda 10 ditëve nga marrja e ankesës së fundit.

6. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Administrative të Apelit ndaj vendimit të Këshillit, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Këshillit. Gjykata vendos për ankimin e paraqitur, brenda 10 ditëve nga paraqitja e tij. Ankimi nuk pezullon procedurat e vlerësimit të kandidatëve të tjerë.

Neni 33

Renditja e kandidatëve

1. Kandidatët e kualifikuar, sipas nenit 32 të këtij ligji, i nënshtrohen vlerësimit nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji.

2. Në përfundim të vlerësimit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë përgatit listën me renditjen paraprake të kandidatëve.

Neni 34

Seanca dëgjimore

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë organizon seancë dëgjimore me jo më shumë se gjashtë kandidatët e renditur më lartë në listë, sipas nenit 33.

2. Kandidatët njoftohen me shkrim nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, të paktën dhjetë ditë përpara datës së seancës dëgjimore.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë merr vendim për miratimin e listës me renditjen e kandidatëve, bazuar në rezultatet e vlerësimit të tyre dhe e publikon atë në faqen e saj të internetit, së bashku me relacionin shpjegues përkatës, që shpjegon analizën dhe masën e përmbyshjes për secilin kriter nga çdo kandidat, si dhe metodologjinë e ndjekur për vlerësimin e njëkohshëm dhe krahasimor të masës së përmbyshjes së kriterëve prej kandidatëve.

Neni 35

Ankimi

1. Kandidatët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për propozimin e renditjes së tyre në listë, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të tij. Ankimi mund të bazohet vetëm në arsyetimin që kanë ndodhur gabime faktike ose procedurale të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e renditjes së kandidatëve. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton vetëm gabimet faktike ose procedurale të cilat mund të kenë ndikuar në rezultatin e renditjes dhe nuk zëvendëson vlerësimin e kriterëve me vlerësimin e saj. Vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit është i formës së prerë dhe kundër tij nuk lejohet rekurs.
2. Në rastet kur gjykata pranon ankimin dhe shfuqizon vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, ky i fundit rishikon renditjen dhe vendos duke marrë në konsideratë vendimin e gjykatës.
3. Vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që propozon renditjen e kandidatëve, merr formë të prerë:
 - a) në rast se brenda afatit ligjor nuk është paraqitur ankim, me përfundimin e afatit të ankimit;
 - b) në rast se brenda afatit ligjor është paraqitur ankim, në momentin kur gjykata merr vendim të formës së prerë për rrëzimin e ankimit apo në momentin kur vendimi përfundimtar i Këshillit hyn në fuqi, pas shfuqizimit të tij me vendim të gjykatës.
4. Këshilli i Lartë i Prokurorisë publikon vendimin përfundimtar në faqen e internetit, duke përfshirë arsyetimin e vendimit, referuar verifikimit paraprak të kushteve ligjore, vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve të kualifikuar në propozimin e emërimit.

Neni 36

Emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë i paraqet Kuvendit të Shqipërisë propozimin për të emëruar si Prokuror të Përgjithshëm një nga tre kandidatët e renditur më lart në listë. Propozimi përfshin vendimin e arsyetuar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
2. Prokurori i Përgjithshëm emërohet në përputhje me nenin 148/a të Kushtetutës.

Neni 37

Betimi dhe fillimi i detyrës

1. Prokurori i Përgjithshëm përpara të se fillojë detyrën realizon betimin sipas formulës: “Betohe më solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.
2. Prokurori i Përgjithshëm betohet përpara Kuvendit të Shqipërisë në një ceremoni publike.

Neni 38

Statusi i Prokurorit të Përgjithshëm

Statusi i Prokurorit të Përgjithshëm përcaktohet në këtë ligj dhe në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, me përjashtim të procedurës së vlerësimit profesional të parashikuar në këtë të fundit.

SEKSIONI III KOMPETENCAT

Neni 39

Kompetencat e Prokurorit të Përgjithshëm

1. Prokurori i Përgjithshëm është drejtuesi i Prokurorisë së Përgjithshme dhe ka përgjegjësi për menaxhimin e punës në administratën e Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm të apelit dhe shkallës së parë.
2. Prokurori i Përgjithshëm ushtron kompetencat e parashikuara në nenin 148/b të Kushtetutës, si dhe kompetencat shtesë si vijon:
 - a) nxjerr udhëzime të përgjithshme me shkrim për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, me përjashtim të atyre të Prokurorisë së Posaçme;
 - b) përcakton strukturën e përgjithshme dhe rregulloren standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, dhe miraton organikën dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme.
 - c) përfaqëson prokurorinë në marrëdhëniet me të tretët dhe ndihmën e ndërsjellë në çështje penale të juridiksionit të përgjithshëm;
 - ç) kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë;
 - d) drejton, bashkërendon dhe mbikëqyr veprimtarinë e policisë gjyqësore;
 - dh) kërkon fillimin e hetimeve për shkelje disiplinore dhe ankesa ndaj oficerëve të policisë gjyqësore;
 - e) i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë;
 - ë) i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të kryejë inspektime tematike ose hetime për shkeljet individuale;
 - f) cakton sistemin e menaxhimit të çështjeve;
 - g) administron sistemin e përgjimeve, sipas legjisllacionit në fuqi;
 - gj) kryen detyra të tjera, të parashikuara në ligj.
3. Në ushtrimin e funksioneve të tij, Prokurori i Përgjithshëm mund t'i delegojë me shkrim kompetenca të caktuara drejtorëve të drejtorive, drejtuesve të seksioneve ose prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas parashikimeve në këtë ligj ose në ligje të veçanta.

Neni 40

Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm

1. Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm përfaqëson Prokurorinë e Përgjithshme në mungesë të Prokurorit të Përgjithshëm ose kur vendi i tij është përkohësisht i lirë.
2. Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm kryen vetëm detyrat që janë të nevojshme:
 - a) për funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme, prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe policisë gjyqësore;
 - b) për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët.
3. Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm zgjidhet, brenda 30 ditëve nga emërimi i Prokurorit të Përgjithshëm, nga radhët e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme me të paktën 10 vjet përvojë si prokuror dhe që janë vlerësuar “shumë mirë” në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale.
4. Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm emërohet nga Prokurori i Përgjithshëm, për një mandat dy vjeçar me të drejtë riemërimi, pasi ka marrë mendimin e mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë. Mendimi i marrë nga organi kolegjal i prokurorisë përkatëse nuk është i detyrueshëm për Prokurorin e Përgjithshëm.
5. Në rast se Zëvendës Prokurori i Përgjithshëm ka pengesë në ushtrimin e detyrave të tij ose për cfarëdo arsye pushon së vepruari si prokuror në atë prokurori, ai/ajo zëvendësohet nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas kriterëve të përcaktuar në paragrafin 3 më sipër.
6. Prokurori i Përgjithshëm miraton me vendim rregulla më të hollësishme mbi procedurën e zgjedhjes së Zëvendës Prokurorit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme.

Neni 41 Buxheti

1. Prokuroria ka buxhet të pavarur, që përballohet nga buxheti i shtetit dhe parashikohet në një kapitull të veçantë të tij.
2. Prokurori i Përgjithshëm përgatit projekt-buxhetin e prokurorisë, i cili përfshin buxhetin për Prokurorinë e Përgjithshme, buxhetin për prokuroritë pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm si dhe buxhetin për policinë gjyqësore të seksioneve pranë prokurorisë.
3. Në rastin kur propozimi i buxhetit të prokurorisë nga Këshilli i Ministrave është i ndryshëm nga ai i propozuar nga Prokurori i Përgjithshëm, ky i fundit ka të drejtë të marrë pjesë në procedurat parlamentare për të mbrojtur projektbuxhetin e propozuar.
4. Në buxhetin e prokurorisë mund të përfshihen edhe të ardhura të tjera, përfshirë fonde nga donatorët ndërkombëtarë, të cilët nuk janë në konflikt interesi me veprimtarinë e prokurorisë.
5. Fondet e marra në përputhje me paragrafin 4 të këtij neni duhet të përdoren në përputhje me marrëveshjet e lidhura me donatorin ndërkombëtar dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.

KREU V DREJTUESIT E PROKURORISË

Neni 42 Drejtimi në prokurori

1. Prokuroritë drejtohen nga drejtuesit e prokurorisë.
2. Drejtuesit e prokurorisë emërohen në detyrë dhe ushtrojnë kompetencat e tyre sipas ligjit mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 43

Kompetencat e drejtuesve në drejtimin e prokurorisë

1. Drejtuesit e prokurorisë ushtrojnë këto detyra:
 - a) organizojnë punën dhe marrin masat e nevojshme për mirëfunksionimin e prokurorisë;
 - b) përfaqësojnë prokurorinë në marrëdhënie me të tretët;
 - c) organizojnë shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kriteret objektive dhe transparente, që përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me këtë ligj;
 - ç) ngrenë grupe hetimore për çështje të veçanta;
 - d) organizojnë diskutime për çështje të natyrës juridike;
 - dh) mbikëqyrin disiplinën në punë të prokurorëve dhe kërkojnë fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve;
 - e) bashkërendojnë punën me drejtoritë përkatëse në Prokurorinë e Përgjithshme dhe policinë gjyqësore;
 - ë) bashkërendojnë punën me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për çështje që lidhen me karrierën dhe rritjen profesionale të prokurorëve;
 - f) mbikëqyrin organizimin dhe funksionimin e administratës së prokurorisë për veprimtaritë që nuk lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale, në rast se nuk është parashikuar ndryshe me ligj;
 - g) sigurojnë zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm;
 - gj) drejtojnë, bashkërendojnë dhe mbikëqyrin veprimtarinë e policisë gjyqësore nën juridiksionin e tyre;
 - h) sigurojnë përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori;
 - i) kujdesen për çështjet e ruajtjes dhe të sigurisë në prokurori;
 - j) miratojnë rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë dhe, në raste të justifikuara, përshtasin strukturën standarde të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm me nevojat e prokurorisë dhe aftësitë e personave në detyrë
 - k) mbikëqyrin respektimin e etikës së prokurorit dhe planifikimin e punës së tyre, si dhe përmbushin angazhimet ligjore për vlerësimin profesional të prokurorëve dhe të oficerëve të policisë gjyqësore;
 - l) mbajnë kontakte me ekipet audituese të institucioneve të tjera, marrin dijeni për qëllimin dhe objektin e kontrollit dhe u krijojnë kushtet e nevojshme.

Neni 44

Kompetencat në ushtrimin e ndjekjes penale

Drejtuesit e prokurorisë kanë këto kompetenca në lidhje me ushtrimin e ndjekjes penale:

- a) koordinojnë veprimtarinë me prokuroritë e tjera për çështje konkrete;

- b) kërkojnë informacion për ecurinë e procedimeve dhe, nëse është e nevojshme, nxjerrin udhëzime, sipas këtij ligji;
- c) japin urdhra të detyrueshme për policinë gjyqësore lidhur me ushtrimin e funksioneve;
- ç) verifikojnë përfundimin e çështjeve dhe, kur është e nevojshme, sugjerojnë kryerjen e veprimeve të mëtejshme proceduriale përpara se të merret vendimi mbi mënyren e përfundimit të hetimeve paraprake;
- d) marrin masa për zëvendësimin e prokurorit të çështjes, në rastet e parashikuara me ligj;
- dh) garantojnë zbatimin korrekt të udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 45

Zëvendës Drejtuesi i prokurorisë

1. Zëvendës drejtuesi i prokurorisë përfaqëson prokurorinë në rast mungese të drejtuesit ose kur vendi i tij mbetet për kohësisht i lirë.
2. Zëvendës drejtuesi i prokurorisë kryen vetëm detyrat që janë të nevojshme:
 - a) për funksionimin e prokurorisë;
 - b) për përfaqësimin e prokurorisë me të tretët;
 - c) për çdo detyrë tjetër të përcaktuar në udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm.
3. Zëvendës drejtuesi i prokurorisë emërohet nga radhët e drejtuesve të seksioneve, të cilët:
 - a) janë vlerësuar “shumë mirë” në tre vlerësimet e fundit të performancës etike dhe profesionale;
 - b) kanë të paktën pesë vjet përvojë si prokuror, nga të cilët të paktën tre vjet në të njëjtin nivel.
4. Zëvendës drejtuesi i prokurorisë emërohet për një mandat dy vjeçar, me të drejtë rrimërimi, nga drejtuesi i prokurorisë, pasi të ketë marrë mendimin e mbledhjes së prokurorëve të prokurorisë. Mendimi i mbledhjes së prokurorëve nuk është i detyrueshëm për drejtuesin.
5. Në rast se zëvendës drejtuesi nuk mund të ushtrojë detyrat e tij ose për çfarëdo arsye pushon së vepruari si prokuror në atë prokurori, zëvendësohet sipas kriterëve të përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni.
6. Prokurori i Përgjithshëm miraton rregulla më të detajuara për emërimin e zëvendës drejtuesit të prokurorisë.

KREU VI

ORGANIZIMI I BRENDSHËM I VEPRIMTARISË SË PROKURORISË

SEKSIONI I

MARRËDHËNIET BRENDA STRUKTURËS SË PROKURORISË

Neni 46

Pavarësia procedurale e prokurorëve³

³ Pavarësia, në kuptimin e ngushtë të fjalës, mund të kuptohet si një sistem në të cilin në ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara me ligj, prokurorët e ndryshëm nga prokurori i përgjithshëm nuk duhet të marrin miratimin paraprak të prokurorëve më të lartë dhe as konfirmim të mëpasëshëm për veprimet e tyre. [...]” CDL-AD(2010)040, Report on

1. Prokurorët ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur, gjatë hetimit dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim.
2. Zëvendësimi i prokurorit të çështjes lejohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

Neni 47 **Udhëzimet e përgjithshme⁴**

1. Prokurorët më të lartë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme dhe të arsyetuara me shkrim të cilat janë të detyrueshme për prokurorët më të ulët. Prokurorët e Prokurorisë së Posaçme i nënshtohen vetëm udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.
2. Udhëzimet e përgjithshme, sipas këtij neni, mund të jenë të natyrës administrative ose procedurale, kryesisht:
 - a) për koordinimin e punës ndërmjet prokurorive të ndryshme apo mes tyre dhe policisë gjyqësore, të përfshira në hetime të përbashkëta, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale;
 - b) për të siguruar zbatimin e njëjtë të ligjit dhe ndjekjes penale, bazuar në vendimet gjyqësore;
 - c) për të siguruar zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave, për luftën kundër kriminalitetit;
 - ç) për raste të tjera që nuk kanë lidhje me çështje konkrete.
3. Udhëzimet e përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm botohen në Fletoren Zyrtare.
4. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për çështje të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë që drejtojnë. Udhëzimet e përgjithshme të drejtuesve të prokurorive publikohen në faqen e internetit të prokurorisë.

Neni 48 **Kundërshtimi i udhëzimeve të përgjithshme**

1. Prokurori mund të kundërshtojë paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e udhëzimeve të përgjithshme, duke bërë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë⁵.
2. Prokurori është i detyruar të ndjekë udhëzimet e ankimuara me përjashtim të rastit kur vlerëson se janë haptazi në kundërshtim me ligjin.

European Standards as regards the Independence of the Judicial System: Part II the Prosecution Service, §§28, 30 and 31.

⁴ Opinion i Komisionit të Venecias CDL(2013)039 paragrafi 65 shprehet si vijon: “*Më në fund në përputhje me parimet e transparencës dhe llogaridhënies, projektligji duhet të specifikojë se të gjitha udhëzimet e përgjithshme dhe udhëzime të politikave të nxjerra të prokurorëve publikë duhet të publikohen.*”

⁵ Venice commission opinion CDL(2013)039 paragraph 64 says as folloës: “*To sum up, ideally all instructions to an inferior prosecutor should be given in writing, and oral instructions should be confirmed in writing upon request (or eithdraën) and in case of an allegation that an instruction is illegal a court or an independent body like a prosecutorial council should decide on the legality of the instruction.*”

Neni 49

Udhëzimet për çështje konkrete

1. Udhëzime për çështje konkrete mund të jepen nga:
 - a) Prokurori i Përgjithshëm për Prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme;
 - b) Drejtuesi i prokurorisë së apelit pranë gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët në prokurorinë përkatëse;
 - c) Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm për prokurorët e prokurorisë përkatëse.
 - ç) Drejtuesit e seksioneve për prokurorët e caktuar në seksionin përkatës.
2. Udhëzime për çështje konkrete nuk janë të detyrueshme dhe kufizohen në dhënien e orientimeve për zgjidhjen e problemeve të natyrës së përgjithshme dhe nuk mund të përmbajnë udhëzime të detajuara për mënyrën e procedimit apo që ndikojnë mbi prokurorin e çështjes në lidhje me vlerësimin e tij.⁶
3. Udhëzimet në lidhje me procedime konkrete, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, mund të jepen kryesisht në momentin e caktimit të çështjes për ndjekje prokurorit, por edhe më pas, kur vlerësohet e nevojshme për mbarëvajtjen e ecursisë së procedimit.
4. Udhëzimet sipas këtij neni duhet të jepen me shkrim dhe të jenë të arsyetuara. Përjashtimisht, kur rrethanat nuk e lejojnë, udhëzimet mund të jepen verbalisht, dhe, brenda një kohe të arsyeshme, të konfirmohen me shkrim.
5. Kur prokurori nuk është dakord me udhëzimet e dhëna, ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime lidhur me to. Drejtuesi i prokurorisë apo drejtuesi i seksionit është i detyruar të japë shpjegime mbi udhëzimet dhe t'i përsërisë ato në të njëjtën mënyrë, përndryshe udhëzimi konsiderohet i tërhequr.^[4] Në rast se prokurori ndaj të cilit është përsëritur udhëzimi, vendos të mos e ndjekë atë, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit.
6. Udhëzimi dhe përgjigjet i bashkangjiten akteve të procedimit.

Neni 50

Zëvendësimi i prokurorit

1. Prokurori mund të zëvendësohet në rastet dhe kushtet e parashikuara nga neni 27 i KPP.
2. Prokurori mund të zëvendësohet e dhe kur, për shkak të mungesës ose paaftësisë së tij për punë, nuk është në gjendje të ushtrojë funksionet apo e të respektojë afatet ligjore.

⁶ Komisioni i Venecias: Autoriteti për të dhënë udhëzime prokurorëve më të ulët duhet të shtrihet vetëm të udhëzimet e përgjithshme dhe jo në trajtimin e çështjeve konkrete. Ky kufizim duhet të shprehet qartësisht në ligj. Opinioni i Komisionit të Venecias CDL(2013)039, paragrafi 61 thotë si vijon: "... do të ishte e përshtatshme për të theksuar mbrojtjen kundër ndërhyrjes hierarkike në çështje individuale duke përcaktuar se çdo urdhër i veçantë apo udhëzimet e dhëna prokurorit publik nga prokurori publik më i lartë duhet gjithmonë të bëhet me shkrim, së bashku me të drejtën e prokurorit publik në fjalë për të kërkuar arsyetim të mëtejshëm për udhëzim, i cili duhet të jepet në formë të shkruar.

Neni 51

Raportimi vjetor te Prokurori i Përgjithshëm

1. Prokurori i Përgjithshëm mund të marrë periodikisht të dhëna dhe informacione nga prokuroritë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së tyre.
2. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të apelit dhe shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm përgatisin, brenda muajit Mars të çdo viti, raportin vjetor mbi ecurinë e punës në prokurorinë përkatëse përgjatë vitit paraardhës dhe ia paraqesin Prokurorit të Përgjithshëm. Raporti publikohet në faqen e internetit te Prokurorisë së Përgjithshme.
3. Drejtuesit e prokurorive janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave që përmbahen në raportin vjetor.
4. Në rast se raporti jep shkak për të besuar se është kryer një shkelje disiplinore, Prokurori i Përgjithshëm mund të depozitojë kërkesë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për hetimin e shkeljes disiplinore.
5. Përmbajtja e raporti vjetor që përgatitet nga drejtuesit e prokurorisë miratohet me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 52

Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë e Përgjithshme informojnë publikun dhe median në lidhje me veprimtarinë e prokurorisë dhe, për çështje të veçanta, duke zbatuar kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit.
2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen nga ose nën mbikëqyrjen e një prokurori të caktuar për marrëdhënie me publikun.

Neni 53

Shmangia e konfliktit të interesit

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, prokurorët detyrohen të shmangin çdo konflikt interesi, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

SEKSIONI II

ADMINISTRIMI I PUNËS NË PROKURORI

Neni 54

Drejtimi administrativ i prokurorisë

1. Drejtuesi i prokurorisë është përgjegjës për mbarëvajtjen e punës dhe marrjen e masave dhe veprimeve për të siguruar efikasitetin dhe ligjshmërinë e veprimtarisë së prokurorisë që drejton.
2. Prokurorët kanë detyrimin të informojnë drejtuesin e prokurorisë, sa herë që kërkohet prej këtij të fundit, lidhur me punën mbi çështje të caktuara dhe vendimmarrjen si dhe, në raste të veçanta, për problematika që shfaqen në ecurinë e procedimit.
3. Drejtuesi i prokurorisë merr masa për të garantuar përmbushjen e funksioneve administrative të prokurorisë, përfshirë mbajtjen e regjistrave dhe raporteve, mbajtjen e protokollit dhe arkivës, administrimin financiar dhe material, menaxhimin informatik, ndarjen e brendshme e detyrave, shqyrtimin e ankesave dhe detyra të tjera që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë.

Neni 55 **Shpërndarja e çështjeve**

1. Prokurori i Përgjithshëm përcakton rregulla më të detajuara për:
 - a) procedurat e shpërndarjes së çështjeve, të cilat të sigurojnë transparencë dhe mundësi të mjaftueshme verifikimi;
 - b) kriteret për shpërndarjen e çështjeve, bazuar në ngarkesën e çështjeve dhe specializimin e prokurorëve;
 - c) rastet dhe kriteret për ri-shpërndarjen e çështjeve;
 - ç) mënyrën e monitorimit dhe dokumentimit të tyre.Rregullat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij nenin duhet të parashikojnë që çështja t'i caktohet paraprakisht të paktën tre prokurorëve, ndërsa caktimi përfundimtar të kryhet me short, në mënyrë elektronike.
2. Drejtuesi mbikqyr procesin e shpërndarjes së çështjeve, bazuar në rregullat e miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm.
3. Drejtuesi i prokurorisë siguron paanshmërinë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës së prokurorisë, duke marrë parasysh nevojën për shpërndarjen e drejtë të ngarkesës mes prokurorëve.
4. Prokuroria e Posaçme përcakton rregullat e veta për shpërndarjen e çështjeve bazuar në parimin e transparencës dhe objektivitetit, sipas paragrafit 1 të këtij neni.
5. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë kryen inspektime të rregullta mbi caktimin e çështjeve.

SEKSIONI III **MBLEDHJET E PROKURORËVE**

Neni 56 **Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme**

1. Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme përbëhet nga Prokurori i Përgjithshëm dhe prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme.
2. Mbledhja e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme:
 - a) merr në shqyrtim planin e punës dhe raportin e punës së prokurorisë;

- b) referon dhe diskuton mbi çështjet administrative të funksionimit të organit;
 - c) jep mendim mbi rregulloren e organizimit të brendshëm të Prokurorisë së Përgjithshme;
 - ç) diskuton mbi çështje që lidhen me personelin, formimit profesional, disiplinën, sigurinë, organizimin e punës dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e prokurorisë;
 - d) jep mendim për projekt udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm;
 - dh) evidenton dhe diskuton probleme të zbatimit të ligjeve dhe akteve normative me rëndësi në veprimtarinë e prokurorisë;
 - e) jep mendim lidhur me raportin e punës së Prokurorisë së Përgjithshme;
 - gj) diskuton çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë.
3. Mbledhja e Prokurorisë së Përgjithshme thirret me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm. Prokurori i Përgjithshëm ka detyrimin të thërrasë mbledhjen e prokurorëve, kur kërkohet nga të paktën një e treta e prokurorëve të Prokurorisë së Përgjithshme.
4. Për të gjitha mbledhjet e organit kolegjal të Prokurorisë së Përgjithshme mbahet procesverbal i përmbledhur me shkrim.

Neni 57

Mbledhja e prokurorëve të prokurorive të tjera

- 1. Drejtuesi i prokurorisë thërret dhe drejton mbledhjen e prokurorëve të strukturës përkatëse, për të diskutuar çështje me rëndësi të veprimtarisë së prokurorisë.
- 2. Mbledhja e prokurorëve ka detyrat e mëposhtme:
 - a) jep mendim mbi rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë;
 - b) miraton përshkrimet e punës të të gjitha kategorive të nëpunësve civilë dhe punonjësve të prokurorisë dhe përshtat strukturën standard të nxjerrë nga prokurori i Përgjithshëm me nevojat e prokurorisë dhe aftësitë e personave në detyrë;
 - c) vendos ngritjen e seksioneve dhe miraton strukturën / përbërjen e tyre;
 - ç) jep mendim mbi projekt-buxhetin e prokurorisë përkatëse, përpara se të dërgohet në Prokurorinë e Përgjithshme;
 - dh) diskuton çdo çështje tjetër me rëndësi për veprimtarinë e prokurorisë, përfshirë ato që lidhen me disiplinimin, karrierën dhe trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve të prokurorisë
 - e) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.
- 2. Drejtuesit e prokurorive kanë detyrimin të thërrasin mbledhjen e prokurorëve, kur kërkohet nga të paktën një e treta e prokurorëve.

Neni 58

Procesi vendimmarrës në mbledhjet e përgjithshme të prokurorëve

- 1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Të gjithë prokurorët e prokurorisë në kohën e votimit janë anëtarë dhe kanë detyrimin të votojnë. Mbledhja është e vlefshme kur janë të pranishëm të paktën dy të tretat e të gjithë anëtarëve.
- 2. Prokurori i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Prokurorisë thërret mbledhjen e prokurorëve sa herë që është e nevojshme për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga nenet 56 dhe 57 të këtij ligji.

Data, vendi dhe rendi i ditës u njoftohen anëtarëve, të paktën tre ditë përpara zhvillimit të saj dhe shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtim.

3. Në rast se rendi i ditës parashikon vendimmarrje, dokumentacioni duhet të përfshijë gjithashtu edhe projektvendimin, së bashku me arsyetimin përkatës të propozuar.

4. Në raste të veçanta, me kërkesë të çdo anëtarë dhe me votat e të gjithë anëtarëve, mbledhja mund të diskutojë dhe të marrë vendim edhe mbi çështje që nuk përfshihen në rendin e ditës.

5. Mbledhjet e prokurorëve regjistrohen dhe procesverbali i përmbledhur i diskutimeve, së bashku me vendimet përkatëse, publikohen në faqen zyrtare të internetit të prokurorisë. Drejtuesi konfirmon saktësinë e procesverbalit dhe e nënshkruan atë.

6. Në rastin kur mbledhja e përgjithshme diskuton raportin vjetor të prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm njoftohet për mbledhjen dhe projektraportin, të paktën një javë përpara mbledhjes. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhje ose të dërgoj një përfaqësues të tij.

KREU VII ADMINISTRATA E PROKURORISË

Neni 59 Struktura e prokurorive

1. Struktura e prokurorive përfshin, ndër të tjerë:

a) prokurorët e komanduar, sipas nenit 64 të këtij ligji;

b) nëpunësit publikë që kryejnë funksione administrative, përfshirë ekspertët;

c) praktikantë prokurorë;

ç) punonjës të tjerë që kryejnë detyra mbështetëse, përfshirë teknikë dhe funksione të tjera për veprimtarinë e prokurorisë.

2. Numri i prokurorëve të komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme si dhe numri i nëpunësve civilë dhe punonjësve të strukturës në secilën prokurori, me përjashtim të Prokurorisë së Posaçme, përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm brenda buxhetit të prokurorisë.

3. Trajtimi financiar i nëpunësve civilë dhe punonjësve të administratës së prokurorive barazohet me atë të nëpunësve civile dhe punonjësve të administratës të sistemit gjyqësor, pranë së cilës funksionon prokuroria.

Neni 60 Statusi i personelit të prokurorive

1. Nëpunësit civilë të administratës së Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil.

2. Marrëdhëniet e punës të personelit mbështetës rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

3. Statusi i prokurorëve të komanduar përcaktohet në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 61

Praktikantët prokurorë

1. Personat e diplomuar në drejtësi që plotësojnë kërkesat e përgjithshme për punësim në administratën publike mund të punësohet si praktikantë prokurorë, bazuar në Kodin e Punës, për një periudhë deri në një vit.
2. Praktikantët prokurorë mund të punësohen në prokuroritë e shkallës së parë dhe ato të apelit.
3. Kandidatët që diplomohen në drejtësi me një mesatare të lartë do të kenë avantazh në punësim.

Neni 62

Struktura e Prokurorisë së Përgjithshme

1. Struktura e Prokurorisë së Përgjithshme përbëhet nga:
 - a) sekretariati i përgjithshëm;
 - b) kabineti;
 - c) drejtoritë;
 - ç) seksionet, përfshirë ato të ekspertizës, të ndihmës për subjektet e posaçme, sipas Kodit të Procedurës Penale, etj.;
2. Prokurori i Përgjithshëm përcakton strukturën dhe organikën e Prokurorisë së Përgjithshme në rregulloren e funksionimit të saj.

Neni 63

Sekretari i Përgjithshëm

1. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Përgjithshme është nëpunësi më i lartë civil i Prokurorisë së Përgjithshme dhe i të gjitha prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Posaçme është nëpunësi më i lartë civil në Prokurorinë e Posaçme.
3. Sekretari i përgjithshëm drejton veprimtarinë administrative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të prokurorive të tjera pranë gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, nën autoritetin e Prokurorit të Përgjithshëm. Sekretari i Përgjithshëm i Prokurorisë së Posaçme drejton veprimtarinë administrative të Prokurorisë së Posaçme, nën autoritetin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

Neni 64

Prokurorët e komanduar në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Prokurorët komandohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në Prokurorinë e Përgjithshme, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
2. Sektori i prokurorëve të komanduar është strukturë ndihmëse dhe këshilluese që studion ankimet, dosjet penale, përgatit relacionin për çështjet objekt gjykimi në Gjykatën dhe Gjykatën Kushtetuese, përgatit projekt-akte, bën kërkime ligjore, përfaqëson Prokurorinë e Përgjithshme në çështjet gjyqësore të karakterit civil dhe administrativ, si dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vlerësimi i punës së prokurorëve të komanduar kryhet nga drejtuesi i prokurorisë bazuar në mendimin e dhënë nga prokurori më të cilin punon prokurori i komanduar, duke zbatuar kur është e nevojshme dispozitat mbi vlerësimin etik dhe paraprak të magistratëve, të përcaktuar në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 65

Sektorët e ekspertizës

1. Pranë prokurorive mund të ngrihen dhe funksionojnë sektorët e ekspertizës, që kanë në dispozicion mjete të posaçme teknike dhe ekspertë të specializuar në fusha të caktuara të shkencës.
2. Ekspertët duhet të kenë përfunduar minimalisht studimet në nivelin master në fushën e tyre të ekspertizës dhe të kenë të paktën pesë vjet përvojë në atë fushë.
3. Marrëdhëniet e punës së ekspertëve rregullohen sipas dispozitave të ligjit për nëpunësin civil.
4. Ekspertët veprojnë nën drejtimin dhe mbikqyrjen e drejtuesit të prokurorisë ku ushtrojnë funksionet e tyre.
5. Këshilli i Ministrave parashikon fonde për ngritjen e shërbimeve të ekspertimit, bazuar mbi kërkesat e prokurorisë sipas rregullave të këtij ligji.

Neni 66

Asistenca ndaj subjekteve me status të posaçëm

1. Prokuroritë duhet të garantojnë shërbimet e nevojshme për trajtimin e subjekteve që gëzojnë status të posaçëm sipas Kodit të Procedurës Penale.
2. Secila prokurori duhet të ketë në përbërje të saj të paktën dy koordinatorë, të diplomuar në psikologji, sociologji ose fusha të tjera të posaçme.

Neni 67

Trajnimi

1. Trajnimi profesional i nëpunësve civilë sigurohet nëpërmjet përfshirjes së tyre në programet e mëposhtme:
 - a) programi fillestar i trajnimit, në bazë të të cilit trajnohen kandidatët për t'u rekrutuar në shërbimin civil;
 - b) programi vazhdues i trajnimit, mbi bazën e të cilit trajnohen nëpunësit civilë në detyrë.

2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, Ministrinë e Drejtësisë, prokuroritë dhe institucione të tjera sigurojnë trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm profesional të nëpunësve civilë dhe përgatisin kurrikulat për trajnimin e tyre fillestar për një periudhë prej të paktën një muaji.

KREU VIII

MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET E TJERA

Neni 68

Marrëdhëniet me Këshillin e Ministrave

1. Jo më vonë se data 31 mars e çdo viti, Këshilli i Ministrave miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit.
2. Rekomandimet miratohen në mbledhje publike të Këshillit të Ministrave, pas debatit të ministrave të interesuar. Rekomandimet duhet të përmbajnë edhe informacion mbi ndryshimet e buxhetit që janë të nevojshme për realizimin e tyre.
3. Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura rekomandimet e Këshillit të Ministrave drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje publike të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit të tyre nga Këshilli i Ministrave.
4. Në marrëdhëniet e Prokurorit të Përgjithshëm dhe Drejtuesit të Prokurorisë së Posacme me Këshillin e Ministrave ndalohen rekomandimet për të proceduar ose jo për çështje konkrete.
5. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet Ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën a zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.

Neni 69

Marrëdhëniet me Kuvendin e Shqipërisë

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme, sipas juridiksionit përkatës, raportojnë në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, të paktën një herë në vit. Raportimi përfshin të dhëna dhe shpjegime për numrin, llojet, shtrirjen territoriale, intensitetin dhe format e kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë.
2. Prokurori i Përgjithshëm informon mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën ndaj kriminalitetit, si vijon:
 - a) nëse rekomandimet periodike të dhëna nga Këshilli i Ministrave janë përkthyer, sipas nevojës, në udhëzime të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;
 - b) nëse udhëzimet e nxjerra nga Prokurori i Përgjithshëm, sipas gërmës “a” më sipër, janë zbatuar dhe si kanë ndikuar ato mbi gjendjen e kriminalitetit në fushat e rekomanduara;
 - c) nëse është monitoruar prej Prokurorit të Përgjithshëm respektimi i këtyre udhëzimeve nga ana e prokurorëve.

3. Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme parashtrajnë gjithashtu përpara Kuvendit të dhëna të detajuara lidhur me efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe me elementë të tjerë thelbësorë në veprimtarinë e institucioneve përkatëse.

4. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme bashkëpunojnë me komisionet e hetimeve parlamentare, sipas dispozitave ligjore në fuqi. Në çdo rast, hetimi penal është i pavarur nga hetimet e komisioneve parlamentare.

Neni 70

Komisioni i Ligjeve në Kuvend

1. Komisioni i Ligjeve në Kuvend vlerëson paraprakisht të dhënat e paraqitura përmes raportimit, sipas nenit 69 të këtij ligji, dhe i dërgon Kuvendit mendimin e tij.

2. Komisioni i Ligjeve është gjithashtu përgjegjës për shqyrtimin paraprak të propozimeve për buxhetin e strukturës së Prokurorisë dhe ndjek në vazhdimësi nevojat buxhetore të Prokurorisë.

Neni 71

Marrëdhëniet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë

1. Marrëdhëniet e prokurorisë me Këshillin e Lartë të Prokurorisë përcaktohen në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

2. Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme raportojnë, të paktën një herë në vit, në Këshillin e Lartë të Prokurorisë lidhur me ecurinë e veprimtarisë së strukturave përkatëse.

Neni 72

Marrëdhëniet me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë

1. Prokurori i Përgjithshëm dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për çështje në juridiksionin e tij dhe të informojnë lidhur me shkeljet disiplinore dhe problematikat që hasin në ushtrimin e veprimtarive të tyre.

2. Rregulla të veçanta mbi mënyrën e funksionimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përcaktohen në ligjet e posaçme në fuqi.

Neni 73

Marrëdhëniet me Ministrin e Drejtësisë

1. Ministri i Drejtësisë mbështet Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme dhe Kryetarin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në shqyrtimin paraprak të nevojave të buxhetit të tyre dhe i paraqet dhe mbron ato në mbledhjen e Këshillit të Ministrave.
2. Ministri i Drejtësisë ka detyrimin të depozitojë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ankesat që paraqiten kundër prokurorëve.

Neni 74
Marrëdhëniet me Policinë Gjyqësore

1. Prokurorët drejtojnë dhe kontrollojnë veprimtarinë hetimore të policisë gjyqësore, në përputhje me ligjin procedural penal dhe parashikimet e bëra në ligjin organik për policinë gjyqësore.
2. Urdhrat dhe udhëzimet e karakterit të përgjithshëm dhe të posaçëm që lidhen me procedimin penal janë të detyrueshme për policinë gjyqësore.

KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 75
Dispozita kalimtare⁷

1. Prokurorët në detyrë dhe ndihmësit ligjorë në detyrë i nënshtrohen dispozitave të Ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
2. Nëpunësit civilë në detyrë dhe punonjësit në prokurori konsiderohen nëpunës civilë në përputhje me këtë ligj.

Neni 76
Dispozita kalimtare për personat në detyrë në Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme

1. Personat në detyrë në Drejtorinë e Inspektimit dhe të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, konsiderohen të komanduar pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në rastin e prokurorëve, apo të transferuar në Këshillin e Lartë të Prokurorisë në rastin e nëpunësve civil.
2. Me kërkesë të tyre, personat në detyrë të cilët janë caktuar aktualisht për të kryer hetimet e shkeljeve disiplinore konsiderohen të komanduar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

⁷ Sipas nenit 169 të projektligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Neni 77
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 78
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare. { XE "KREU" }

DRAFT